

# UDHËZIME PËR OFERTUESIT

## 1 Të përgjithshme

### 1.1 Objekti

- 1.1.1 Autoriteti Kontraktor fton operatorët ekonomikë të paraqesin oferta për Koncesionin / Partneritetin Publik Privat (PPP), me sistemin e financimit të projektit, për Projektin e përshkruar në seksionin Përshkrimi i Projektit (*Shtojca 14 Termat e Referencës*), dhe në Kriteret Minimale teknike (*Shtojca 13 Specifikimet teknike*) në përputhje me procedurat, termat dhe kushtet e kontratës (*Shtojca 17 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe Shtojca 18 Kushtet e Veçanta të Kontratës*) të përshkruara në këto dokumenta tenderi.
- 1.1.2 Dokumentat e tenderit janë modeluar sipas dokumentave ndërkombëtare për ofertim konkurrues. Lloji i kontratës që do të përdoret specifikohet në Seksionin II.2.2, Formularia e kontratës.
- 1.1.3 Skeduli i planifikuar i ofertimit është si më poshtë:
- |                      |               |
|----------------------|---------------|
| Njoftimi i kontrates | Shtator 2016; |
| Dorëzimi i Ofertave  | Nëntor 2016;  |
| Dhënia e Kontratës   | Janar 2017.   |
- 1.1.4 Ofertuesit do të kërkohen të ofrojnë sigurimin e ofertës siç përshkruhet në paragrafin 4.3 Sigurimi i Ofertës. Ofertuesi i suksesshëm do të kërkohet të dorëzojë sigurinë e ekzekutimit.
- 1.1.5 Projekti do të strukturohet në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin shqiptar për Konkensionet dhe Partneritetet Publike Private nr. 125/2013, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10 korrik 2013, " *Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve / partneritetit publik privat* "dhe VKM 130, datë 12 mars 2014" *Për kryerjen elektronike të procedurave konkurruese në dhënien e Konkensionit / Partneritetit Publik Privat*", (bashkërisht referuar si, "**Ligji për Konkensionet**") mbi bazën e një kontrate Konkensionit / PPP të tipit DBFOT ndërmjet Autoritetit Kontraktuar dhe ofertuesit të suksesshëm ( "**Kontrata e Konkensionit / Partneritetit Publik Privat**"). Afati i kontratës së Konkensionit / Partneritetit Publik Privat është jo më shumë se 35 vjet dhe jo më pak se 15 vjet, në bazë të periudhës së ofruar nga Ofertuesi i suksesshëm (siç përcaktohet në *paragrafin 7.2.1*).

1.1.6 Çdo vit gjatë Fazës Operative të projektit, koncesionari ("**Koncesionari**") do t'i paguajë Autoritetit Kontraktor një tarifë në shumën një përqindje të të Ardhurave Vjetore Bruto të ofruar nga Ofertuesi i Suksesshëm sipas kushteve të përcaktuara në Kontratën e Koncesionit / Partneritetin Publik Privat ("**Tarifa e Koncesionit**").

## **1.2 Burimi i Fondeve**

1.2.1 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është e interesuar të shqyrtojë mundësinë e bashkë-financimit të projektit të Ofertuesit të Suksesshëm në bazë të politikës së "Financimit nga BERZH të palëve private në koncesione".

## **1.3 Kostot**

1.3.1 Ofertuesi përballon të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij dhe autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës apo të mbajë për këto kosto pavarësisht sjelljes ose rezultatit të procesit të ofertës. Duke përfshirë, pa kufizim, të gjitha kostot dhe shpenzimet në lidhje me përfshirjen e ofertuesit në vizitat në terren dhe inspektimet, dhe / ose të gjitha proceset e tjera të mbledhjes së informacionit, intervistat, përgatitjen e përgjigjeve ndaj pyetjeve dhe / ose kërkesave për sqarim drejtuar Autoritetit Kontraktor.

## **1.4 Mbledhja dhe vizita në kantjer para tenderit**

1.4.1 Një takim sqarues dhe një vizitë në terren do të kryhen më 06 tetor 2016, në orën 10 të paradites [20 ditë pas nisjes së tenderit],. Operatorët Ekonomikë të cilët synojnë të marrin pjesën në këtë takim dhe vizitë në terren duhet të kontaktojnë Autoritetin Kontraktor me faks ose me email në adresën e specifikuar në *SEKSIONIN I paragrafi 1.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës, të paktën përpara datës 05 tetor 2016.*

1.4.2 Gjatë këtij takimi sqarimi, Ofertuesit e mundshëm mund të kërkojnë sqarime të kriterëve të projektit, kriterëve për kualifikim ose aspekte të tjera në këtë Dokumentacion Tenderi. Ofertuesi këshillohet të marrë pjesë në ndonjë takim apo vizitë në kantjer para-tenderimit.

1.4.3 Ofertuesi këshillohet të vizitojë dhe kontrollojë kantjerin dhe rrethinat ku do të realizohet Projekti, të marrë vetë në përgjegjësinë e tij të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e tenderit dhe të lidhë një kontratë koncesioni / Partneriteti Publik Privat. Kostot e vizitës në kantjer do të përballohen nga vetë operatori ekonomik.

1.4.4 Ofertuesit dhe ndonjë prej personelit ose agjentëve të tij do t'ju jepet leja nga Autoriteti Kontraktor për të hyrë në ambientet e tokat e tij për qëllime të inspektimit të tillë, por vetëm me kusht të shprehur se ofertuesi, personeli dhe agjentët e tij do të lirojnë dhe sigurojnë Autoritetin Kontraktor, personelin e tij dhe agjentët nga dhe kundër çdo detyrimi në lidhje me to dhe as Autoriteti Kontraktor, as personeli ose agjentët e tij nuk do të jenë përgjegjës për vdekjen ose plagosjen personale, humbjen ose dëmtimin e pronës dhe çdo humbje tjetër, dëmtim, kosto dhe shpenzime të shkaktuara si rezultat i inspektimit.

## 2 Ofertuesit që kualifikohen

### 2.1 Kriteret e Kualifikimit

- 2.1.1 Ofertimi është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta nga çdo vend apo vende të cilat plotësojnë/nuk plotësojnë kriteret minimale në lidhje me përvojën e përgjithshme dhe të veçantë të ofertuesit, dhe pozicionin e tij financiar, përcaktuar në *Shtojcën 9 (Dëshmi të Kualifikimit / Formulari i Pjesëmarrjes)*, siç tregohet nga përgjigjet e Ofertuesit në Formularin e kualifikimit bashkëngjitur këtij njoftimi dhe dokumentacionin tjetër të kërkuar. Kriteret specifike për sipërmarrjet e përbashkëta përcaktohen në *Shtojcën 9 (Dëshmi të Kualifikimit / Formulari i Pjesëmarrjes)*, paragrafi 3. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që të heqë devijime të vogla nga kriteret, në qoftë se ato nuk ndikojnë materialisht aftësinë e ofertuesit për të realizuar kontratën.
- 2.1.2 Kur Ofertuesi ka për qëllim të marrë shërbime shumë të specializuara (të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës) nga nënkontraktorë të specializuar, nënKontraktorit e tillë do të plotësojnë formularët e kualifikimit, së bashku me hollësi të plota të këtyre të fundit dhe kualifikimet dhe përvojën e tyre. Nënkontraktorët e propozuar duhet të jenë plotësisht të kualifikuar për punën e propozuar atyre.
- 2.1.3 Përveç nëse specifikohet ndryshe në *Shtojcën 9 Dëshmi të Kualifikimit / Formulari i Pjesëmarrjes*, kualifikimi dhe përvoja e nënkontraktorëve të propozuar nga Ofertuesi nuk do të merren parasysh për vlerësimin e Ofertuesit. Ofertuesi më vete (pa marrë parasysh kualifikimin dhe përvojën e nënkontraktorit) duhet të plotësojë kriteret e kualifikimit.

### 2.2 Kritere të tjera kualifikimi

- 2.2.1 Asnjë filial i Autoritetit Kontraktor nuk ka të drejtë të ofertojë apo të marrë pjesë në tender, në çfarëdo cilësie, nëse nuk mund të demonstrohet se nuk ka një shkallë të konsiderueshme të përbashkët pronësie, ndikimi apo kontrolli ndërmjet Autoritetit Kontraktor dhe Filialit.
- 2.2.2 Kur një shoqëri, filialet e saj ose shoqëria mëmë, përveç konsultimit, gjithashtu ka aftësinë për të prodhuar apo furnizuar mallrat, ose për të ndërtuar vepra, ajo shoqëri, filialet e saj ose shoqëria prind normalisht nuk mund të jenë furnizues të mallrave, shërbimeve ose punimeve në një projekt për të cilin ajo ofron shërbime këshilluese, nëse nuk mund të demonstrohet se nuk ka një shkallë të konsiderueshme të përbashkët pronësie, ndikimi apo kontrolli.

- 2.2.3 Ofertuesit duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre të vazhdueshme, në mënyrë të pranueshme për Autoritetin Kontraktor, ashtu sikurse Autoriteti Kontraktor do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme.
- 2.2.4 Raste të mos sigurimit të informacionit thelbësor për vlerësimin e kualifikimeve të ofertuesit, mosdhënies në kohë të sqarimeve apo të mos vërtetimit të informacionit të dhënë, mund të rezultojnë në skualifikimin e ofertuesit.

## **2.3 Kriteret e sipërmarrjes së përbashkët**

2.3.1 Sipërmarrjet e përbashkëta duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- (a) Ndryshimet në një sipërmarrje të përbashkët pas datës së dorëzimit të ofertës do të jenë subjekt i miratimit me shkrim nga Autoriteti Kontraktor. Miratimi i tillë mund të refuzohet në qoftë se (i) partnerët tërhiqen nga një ndërmarrje e përbashkët dhe partnerët e mbetur nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit; (ii) niveli i pjesëmarrjes së partnerëve apo struktura e sipërmarrjes së përbashkët ndryshon thelbësisht, ose (iii) sipërmarrja e përbashkët nuk është e kualifikuar.
- (b) Ofertat nënshkruhen në mënyrë duke lidhur ligjërisht të gjithë partnerët e sipërmarrjes së përbashkët, bashkërisht dhe individualisht, dhe çdo ofertë duhet të dorëzohet së bashku me një kopje të marrëveshjes së sipërmarrjes së përbashkët që parashikon përgjegjësi të përbashkët dhe solidare në lidhje me kontratën.

2.3.2 Ofertuesi mund të paraqesë ose të marrë pjesë, në çfarëdoqilësie çfarëdo qoftë, vetëm në një ofertë. Paraqitja ose pjesëmarrja e një Ofertuesi në më shumë se një ofertë për kontratën do të rezultojë në refuzimin e të gjitha ofertave për atë kontratë në të cilën pala është e përfshirë. Megjithatë, i njëjti nënkontraktor mund të përfshihet në më shumë se një ofertë.

## 2.4 Mashtrimi dhe korrupsioni

2.4.1 Autoriteti Kontraktor kërkon që ofertuesit, furnizuesit, kontraktorët, koncesionerët dhe konsulentët të respektojnë standardin më të lartë të etikës gjatë prokurimit dhe ekzekutimit të kontratave. Në zbatim të kësaj politike, Autoriteti Kontraktor:

- (a) përcakton, për qëllime të kësaj dispozite, termat e parashtruara më poshtë si vijon:
  - (i) "*Praktikë e korruptuar*" nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen, ose kërkimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të ndonjë gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në veprimet e një pale tjetër;
  - (ii) "*Praktikë mashtruese*" nënkupton veprime ose mosveprime, përfshirë keq-përfaqësimet, që me dashje ose nga pakujdesia mashtrojnë, ose përpiqen të mashtrojnë, një palë për të marrë një përfitim financiar ose tjetër, ose për të shmangur një detyrim;
  - (iii) "*Praktikë shtrënguese*" nënkupton cënimin ose dëmtimin, ose kërcënimin për të cënuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë palë apo pronën e palës për të ndikuar në mënyrë të paligjshme veprimet e një pale;
  - (iv) "*Praktikë konfliktuese*" nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve të synuar për të arritur një qëllim të parregullt, duke përfshirë, ndikimin në mënyrë të padrejtë mbi veprimet e një pale tjetër;
- (b) do të refuzojë një ofertë nëse përcakton se ofertuesi është i angazhuar në praktika korruptive, mashtruese, shtrënguese ose konfliktuese në konkurrimin e tij për kontratën në fjalë;
- (c) do të deklarojë një kompani të papërshtatshme për një kohë të pacaktuar ose për një periudhë të caktuar kohore, për t'u kualifikuar në bazë të një kontrate të Autoritetit Kontraktor nëse përcakton se:
  - (i) kompania është e angazhuar në praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose konfliktuese në konkurrimin për, ose në ekzekutimin e kontratës së Autoritetit Kontraktor; ose
  - (ii) kompania është gjetur nga një proces gjyqësor apo hetim tjetër zyrtar të jetë e angazhuar në praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose konfliktuese.

## 3 Dokumentet e Tenderit

### 3.1 Përmbajtja e Dokumenteve të Tenderit

3.1.1 Dokumentet e tenderit përfshijnë dokumentet e renditura më poshtë dhe shtesa të lëshuara në përputhje me paragrafin 3.3.

#### *Njoftimi i Ofertës*

- Seksionet I deri V të këtij dokumenti
- Ftesa për ofertë (Shtojca 2)
- Kriteret e para-kualifikimit (Shtojca 9)
- Kriteret e dhënies së kontratës (Shtojca 10)
- Marrëveshja e Konfidencialitetit (Shtojca 34)
- Formulari i Ankimit tek Autoriteti Kontraktor (Shtojca 21)
- Formulari i Njoftimit të Skualifikimit (Shtojca 15)
- Formulari i Njoftimit të Pranimi të Ofertës (Shtojca 16)
- Formulari i publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës (Shtojca 2)

#### *Udhëzime për Ofertuesit*

Këto Udhëzime për Ofertuesit

#### *Formularët e Dokumentacionit Administrativ*

- Formulari i Dorëzimit të Ofertës (Shtojca 1)
- Formulari i Sigurimit të Ofertës (Shtojca 3)
- Prokura e Posaqme (Formulari 1)
- Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimeve
- Informacione të përgjithshme (Formulari 2)
- Deklarata për statusin ligjor (Formulari 3)
- Deklarata e plotësimit të kërkesave të dokumenteve standarde të Koncensionit / partneritetit publik privat (Formulari 4)
- Deklarata për konfliktin e interesave (Formulari 5)
- Dokumentet e Përgjithshme të Kualifikimit (Formulari 6)
- Aftësia Financiare (Formulari 7)
- Eksperiencia e Përgjithshme në Ndërtim (Formulari 8)
- Eksperiencia e Përgjithshme në Ndërtime Rrugore (Formulari 9)
- Eksperiencia e Përgjithshme në Shërbime të Transportit (Formulari 10)
- Eksperiencia e Përgjithshme në Projektim (Formulari 11)
- Eksperiencia e Veçantë (Formulari 12)
- Përmbledhje: Angazhimet Aktuale të Kontratës (Formulari 13)
- Historiku Gjyqësor (Formulari 14)
- Informacion Konfidencial (Formulari 15)
- Vetë Deklarimet e Ofertuesve të Huaj (Formulari 16)

#### *Formulari i Ofertës Teknike*

**Error! Reference source not found.**

